



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostiguar Priljeno/Prodato Received/Delivety	31. 05. 2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendis	Sasia Kolicina Quantity
SKRMEHOK	2732/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.340/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, sipas Aktgjykimit A.nr.2655/19 të datës 30.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.506/2019 të datës 02.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Mitrovicë, kundër organit të punësimit-Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.506/2019 e datës 02.09.2019 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me nr.01-111/01-0057811/19 i datës 31.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës.**

A r s y e t i m

Komuna e Mitrovicës, me datë 08.05.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Me datë 05.06.2019 Komuna e Mitrovicës ka shpallur njoftimin me nr.01-112/01-0047018/19/2 për kandidatin e suksesshëm për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë. Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 05.06.2019, më datën 02.07.2019 ka parashtruar ankesë me nr.01-111/01-0057811/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mitrovicës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me Vendimin me nr.01-111/01-0057811/19 të datës 31.07.2019 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 31.07.2019 me nr.01-111/01-0057811/19 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës, më datë 02.09.2019 përmes postës ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3984/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.09.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës. Komuna e Mitrovicës më datë 19.09.2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 28.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2655/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 02.09.2019 të parashtruar nga

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3984/2019 të datës 02.09.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 02.07.2019 me nr.01-111/01-0057811/19 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës; Vendimi me nr.01-111/01-0057811/19 i datës 31.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës; Njoftim i datës 05.06.2019 me nr.01-112/01-0047018/19/2 për kandidatin e suksesshëm; Fletë dorëzimi i datës 07.08.2019; Konfirmimi për disponueshmërinë e mjeteve financiare i datës 21.03.2019; Autorizimi i MAP-it i datës 03.05.2019; Kopja e konkursit e datë 08.05.2019 me nr.01-111/01-0034111-2/19; Vendimi me nr.01-030/01-0042530/19 për formimin e komisionit përzgjedhës; Deklaratë e datës 20.05.2019; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 22.05.2019; Raport për përcaktimin e listës së shkurtë i datës 27.05.2019; Kërkesa për punësim e datës 15.05.2019 për bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 15.05.2019 për bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 15.05.2019 bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 15.05.19 për bashkë me dokumentet e kërkuara; Kopja e testit me shkrim i datës 27.05.2019; Formularët e vlerësimit individual; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftimi në lidhje me procedurat e rekrutimit; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 03.06.2019; Vendim i datës 05.06.2019 për emërimin e kandidatit të suksesshëm për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Njoftim për fillimin në procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë; E-mail zyrtar i datës 13.05.2019; E-mail zyrtar i datës 14.05.2019; E-mail zyrtar i datës 22.05.2019; E-mail zyrtar i datës 22.05.2019; E-mail zyrtar i datës 27.05.2019; E-mail zyrtar i datës 28.05.2019; Akt emërimet e anëtarëve të komisionit përzgjedhës dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 19.09.2019 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se zhvillimi i procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesi ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe rrjedhimisht ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për këtë pozitë kanë qenë:

- *Diplomë Universitare apo të avancuar në drejtimin ekonomik, biznes apo të ngjashme;*
- *Katër (4) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se procedura është zhvilluar në kundërshtim Rregulloren Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, ka konstatuar se pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm sepse konkursi për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë, është shpallur brenda institucionit sipas Planit të Personelit, dhe të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në këtë procedurë janë nëpunës civilë të Komunës së Mitrovicës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisionit Përzgjedhës nuk ka qenë në përbërje sipas Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës ka qenë në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Ketë konstatim Kolegji e mbështet duke u bazuar edhe në deklaratën me shkrim të datës 20.05.2019 të organit të punësimit përmes të cilës janë dhëne sqarime lidhur me themelimin e Komisionit Përzgjedhës ashtu siç përcaktuar me nenin 27 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur është vlerësuar si kandidati me më se shumti pike, me gjithsejtë 72.5%, dhe në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë.*

Përkitazi me plotësimin e kriterëve të konkursit, Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Diplomën Nr.1192/0111 të datës 18.01.2011 është konstatuar se kandidati i përzgjedhur me datë 25.10.2010 ka përfunduar studimet themelore në Programin Bachelor i Arteve në Menaxhment në Kolegjin Fama. Ndërsa duke u bazuar në vërtetimin me numër 01-113/01-0040694/19 të datës 15.05.2019 të lëshuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, është konstatuar se kandidati i përzgjedhur është në marrëdhënie pune nga data 01.08.2009 deri me datën e aplikimit, andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se i njëjti i ka plotësuar kriteret themelore të konkursi për pozitën përkatëse.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në bazë të të gjitha provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, në Komunën e Mitrovicës, procedurën e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë e ka zhvilluar në pajtim me nenin 11

paragrafin 1, nenin 13 paragrafin 1 dhe neni 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me nr.01-111/01-0057811/19 të datës 31.07.2019, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.340/2021

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

